



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:290913

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518946

P.nr.88/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurve V (H) R dhe F (H) R qe të dy nga K, rr. „B. C” të akuzuar me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprë penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe par. 1 si dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr. PP//II.nr.1906/2021. Në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 18.03.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ramiz Buxhala, të pandehurve, V. R, mbrojtësit av. M. N, dhe i pandehuri F. R, me mbrojtësin e tij av. A. D, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.V. R, i lindur me në K, rr. „B. C” nr. 48,i biri i H dhe nënës H, e gjinisë R, ka të kryer shkollën fillore i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal....., nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2. F. R, me pseudonim B. T, i lindur me dt. K, rr. „B. C” nr., i biri i H dhe nënës H e gjinisë R, ka të kryer shkollën fillore i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me numër personal....., nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë se me dt....., rreth orës min, në Sheshin F. E në K, në bashkëkryerje e me dashje sulmojnë personin zyrtar në lidhje me detyrën zyrtare duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë të dëmtuarit zyrtarit policor D. R, nga K, në atë mënyrë që: natën kritike derisa i dëmtuari në cilësinë e zyrtarit policor së bashku me kolegët e tij, ishte në zbatim të planit operativ për zbatimin e masave anti Covid, pasi që kanë dëgjuar një zhurmë në lokalitetin „T” policia afrohet aty dhe tenton të kontaktoj me pronarin ,të pandehurin F, por aty del dhe kontakton i pandehuri V, i cili fillimisht i pengon zyrtarët më pas e kap për fyti të dëmtuarin dhe e shtyn, më pas aty del edhe i pandehuri Fatos i cili e fyen dhe kërcënon të dëmtuarin, duke i thënë „Të mys në vend” më pas me duar e shtynë të dëmtuarin duke i shkaktuar gërrvishtje në regjionin e qafës, të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

- Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprë penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe 1 dhe neni 31 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit:

I.V. R, dënohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) viteve nuk kryen veprë të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet konform neni 50 të KPRK-së, nëse i pandehuri kryen veprë penale brenda periudhës verifikuese.

III.OBLIGOHET: I pandehuri V.R, qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, si dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. F. R, dënohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) viteve nuk kryen veprë të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet konform nenit 50 të KPRK-së, nëse i pandehuri kryen veprë penale brenda periudhës verifikuese.

III. Lirohet i pandehuri F. R, nga shpenzimet konform nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

IV. Udhëzohen palët e dëmtuara D. R, dhe M. M, qe të dy zyrtar pranë stacionit policor në K, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr.1906/2021 dates 21.03.2022, kundër të pandehurve V. R dhe F. R qe të dy nga K. Rr. „B. C” nr. , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprë penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze ndaj të akuzuarit V. dhe F. R, me datë 18.03.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku të pandehurit pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit janë deklaruar veç e veç:

1.V. R, ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij av. Marjan Nrecaj, e pranon fajësinë për veprën penale qe u vihet në barrë, i pandehuri deklaron se kam

qenë në gjendje të dehur, jamë i penduar thellë për veprën e kryer, i kam kërkuar falje palëve të dëmtuara, të cilët edhe na e kanë falur, ka qenë kohë pandemie në muajin e 9-të të vitit 2021.

Mbrojtësi i të pandehurit V. R, av. Marjan Nrecaj ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të pandehurin V. R, i cili deklaroi se e pranoj fajësinë, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i pandehuri nuk është recidivist as special e as gjeneral, rasti i parë që i ka ndodh në gjykatë, i njëjti ka shprehur keqardhje thellësisht për rastin që ka ndodh, e krejt kjo ka ndodhur nën ndikimin e alkoolit në kohën kur ka qenë pandemia-Anti Kovid. Gjë në të cilën tërë njerëzimi ka qenë në psikozë a vdekje a jetë. I njëjti me familjen e D. R, janë pajtuar dhe janë kushëri në mes veti, ka shpreh keqardhje është i vetmi ushqyes i familjes, është baba i tre fëmijëve të mitur. Kërkoj nga gjykata që ta liroj dënimi, po ashtu kërkoj që për shkak të gjendjes shëndetësore më tutje nuk do ta përfaqësoj këtë lëndë, dhe shkresat do t'ia dorëzoj të pandehurit V. R.

2.F. R, ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij av.Ardian Desku, e pranon fajësinë për veprën penale që u vihet në barrë, po ashtu edhe pandehuri F. R, ka deklaruar se kam qenë në gjendje të dehur, në atë kohë ka qenë pandemi Covid 19, muaji i nëntë i vitit 2021, jamë i penduar thellë për veprën e kryer, i kam kërkuar falje palëve të dëmtuara, të cilët edhe na e kanë falur gabimin që e kemi bërë.

Edhe mbrojtësi i të pandehuri F. R, av. Ardian Desku, ka deklaruar se i mbrojturi im F. R, e pranoj fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet, pranimi i fajësisë është në harmoni me provat tjera dhe është shprehur në mënyrë vullnetare. Kërkojmë nga gjykata që në momentin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese si dhe bashkëpunimi me gjykatën dhe organet e ndjekjes, keqardhjen dhe pendimin për veprën e kryer. Andaj pranimin e fajësisë në këto rrethana gjykata në bazë të nenit 72 të KPRK-së, mund të shqiptoi dënim me kusht, lidhur me kapitullin e dënimit me kusht.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Prokurori i Shteti nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve V dhe F. R, i propozojë gjykatës që ta bëjë këtë pranim fajësie pasi që është bërë me vullnetin e tyre të lirë, të vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin, po ashtu, ky pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe është bërë pas konsultimit me të mbrojturin e tij.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga dy të akuzuarit V dhe F. R, për veprën penale për të cilën janë ngarkuar, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga dy të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se të akuzuarit, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par. 2 dhe par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarit, t'i shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se të njëjtit e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se dy të akuzuarit:

I pandehuri V. R, e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe pendimin e ti të thellë, për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, nuk ka qenë i dënuar më herët dhe nga ajo kohë, nuk ka kryer vepër tjetër penale, i njëjti gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale, e as nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

I pandehuri F. R, e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe pendimin e ti të thellë, për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, nuk ka qenë i dënuar më herët dhe nga ajo kohë, nuk ka kryer vepër tjetër penale, i njëjti gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale, e as nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata muar se i njëjti vuan nga një sëmundje e rëndë kanceri dhe i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore, ku gjykatës i ka prezantua provat mjekësore Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me kusht i cili ju shqiptua të akuzuarve e i cili konsiston në dënim me burgim për dy të pandehurit në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit në periudhën verifikuese prej dy (2) viteve nuk kryejnë vepër të re penale, si dhe obligimi që i pandehuri V. R, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, si dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa i pandehuri F.R, lirohet nga shpenzimet për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Kërkesa pasurore Juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.

Konform nenit 462 par. 2 i KPPRK-së, të dëmtuarit e lartëcekur, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit F. R u muar konform nenit 452 par. 4 dhe par 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.88/2022 me datë 28.03.2022

Zyrtare Ligjore

Liridona Palushi

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.